

# Roli dhe objektivat e Regjistrit të Kreditit në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen ekonomike

Fjalim i z.Gani Gërguri

Guvernator, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Prezantuar në Seminarin “Përmirësimi i Informacionit Kreditor dhe Regjistri i Kreditit” organizuar nga

USAID/BEEP dhe BQK

Hotel Emerald, Prishtinë, Kosovë

11 maj 2011

## Hyrje

Mirëmëngjesi të gjithëve,

Kam kënaqësinë të flas në hapje të këtij seminari tepër me rëndësi për sektorin financiar dhe ekonominë e vendit tonë në përgjithësi.

Prezantimi im i sotëm është i fokusuar në rolin dhe objektivat e Regjistrit të kreditit në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen ekonomike në Kosovë.

## Përse na nevojitet Regjistri i kreditit?

Në përgjithësi në çdo ndërmjetësim, ndërsa në veçanti me rastin e ndërmjetësimit financiar, çështjet kryesore me të cilat ballafaqohemi janë ajo e rrezikut moral (*anglisht: “moral hazard”*) dhe e seleksionimit jo të favorshëm (*anglisht: “adverse selection”*) të partnerit, në këtë rast të kredikërkuesit. Kështu, bankat shpesh ndodhë të jenë të pasigurta rreth cilësisë së ndonjë projekti ose edhe vetë sjelljes së kredikërkuesit në të ardhmen dhe për pasojë mund të ndodhë që madje edhe projektet e dobishme të mbesin nganjëherë pa përkrahje financiare.

Prandaj, një aranzhman i cili mund të ndihmojë tejkalimin e problemeve të informacionit është këmbimi i këtij informacioni përmes regjistrit të kreditit i cili u mundëson bankave të marrin informacion rreth historisë kreditore të kredikërkuesit. Në përgjithësi, regjistrat e kreditit klasifikohen në bazë të pronësisë dhe perimetrit të informacionit të përfshirë. Kështu, në praktikë ndeshim regjistrë krediti në pronësi publike dhe regjistrë krediti në pronësi private.

Zakonisht, regjistri publik është në pronësi dhe menaxhim nga bankat qendrore ose autoritetet mbikëqyrëse e rregullative të sektorit financiar, ndërsa ai privat në të shumtën e rasteve është i organizuar si një zyre në pronësi të vetë huadhënësve (në Kosovë kemi pasur një aranzhman të tillë ku kanë participuar jo të gjitha bankat), ose si agjencion privat i pavarur i cili thjeshtë “blen” informacionin nga huadhënësit dhe të njëjtin e shet në formë raporti kreditor palëve relevante të interesuara.

Regjistri publik funksionon në parimin e pjesëmarrjes mandatore dhe kjo është karakteristikë edhe e Regjistrit të Kreditit të Kosovës (RKK), i cili parashihet me Ligjin e BQK-së dhe Rregullën bankare nr.XXVIII dhe në të participojnë të gjitha institucionet kredidhënëse – bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Krahas përmirësimit të cilësisë së informacionit kreditor dhe këmbimit të këtij informacioni, një ndër misionet parësore të RKK-së është përforcimi i mbikëqyrjes dhe rregullativës së institucioneve financiare duke kontribuar kështu direkt edhe në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm të sektorit bankar.

Është e rëndësishme të theksoj këtu se pavarësisht aranzhmanit pronësor, analizat empirike flasin për kontribut të theksuar të regjistrit të kreditit në rritjen e disponueshmërisë së kredisë si dhe rritjen e kredidhënies në përgjithësi në ekonominë e vendeve në zhvillim (*shih: Djankov, McLiesh and Shleifer, 2006*) dhe padyshim se kjo vlen edhe për kontributin e RKK-së për të cilin kontribut do të merrni informacion faktik nga prezantim që do t’iu ofrojë zonja Zylfiu, udhëheqëse e RKK-së pranë BQK-së.

## Shkurtimisht mbi rolin e Regjistrimit të kreditit

Një *raison d'être* i ekzistimit të regjistrimit të kreditit është edhe nevoja e këmbimit të informacionit midis institucioneve kredidhënëse. Në këtë rrafsh, ka debate në atë se a duhet këmbyer vetëm informacionin pozitiv apo vetëm atë negativ. I pari zakonisht prodhon reputacionin si kolateral, ndërsa i dyti të ashtuquajturën listë të zezë, kështu që kjo shpesh varet prej legjislacionit dhe kulturës financiare të një vendi. Sidoqoftë, përvojat e të tjerëve tregojnë se solucioni më i mirë është kombinimi i këtyre të dyjave.

Sa i përket rolit të regjistrimit të kreditit, literatura e shumtë na tregon se ky rol pothuajse kudo ka të bëjë kryesisht me:

- Ndërtimin dhe lehtësimin e kulturës së këmbimit të informacionit midis ofruesve të kredisë;
- Ofrimin e një informacioni sa më të plotë dhe të saktë mbi kredikërkuesin për vendimmarrje objektive mbi lejimin e kredisë;
- Reduktimin e rrezikut, përkatësisht parandalimin e gjasës për dështim të kredisë;
- Mbrojtjen e konsumatorëve nga stërngarkimi eventual me borxh duke ndihmuar në dozimin ose kalibrimin e kredisë në pajtim me “kaçikun” - kapacitetin për t’u kthyer kredia përkatëse;
- Hapjen e derës për kredi edhe klientëve të rinj të vlerësuar me rrezik të ultë, por pa ndonjë histori kreditore paraprake.

## Cka po synojmë të arrijmë me përmirësimin e informacionit kreditor në RKK?

Synimi ynë nuk dallon prej synimeve të shumë regjistrave të kreditit nëpër vende të ndryshme të botës. Kështu, presim që edhe të ne përmirësimi i informacionit në RKK ekzistues të sjellë deri tek:

- Përmirësimi i mëtejshëm i qasjes në kredi (rritje e ofertës së kredisë dhe zvogëlim të kostos së saj);
- Promovimi edhe më i theksuar i konkurrencës midis kredidhënëseve;
- Forcimi i mbikëqyrjes bankare (shfrytëzimi në të ardhmen i *rangimeve* për të mbështetur politikën e provizionimit të bazuar *ex ante*);
- Përmirësimi i analizave ekonomike për nevoja të politikave makroekonomike (informacioni kreditor sipas *regjionit, sipas sektorit, sipas cilësisë së huamarrësit, sipas normave të kamatës*, është shumë i dobishëm për dizajnim të politikave të drejta makroekonomike në nivel vendi, përfshirë specifikat regjionale e deri tek efektet e politikave tatimore në rrjedhën e kreditit në ekonomi );
- Përmirësimin e rregullativës bankare (regjistri i kreditit duhet të ofrojë informacion për analizë të adekuatshmërisë së provizionimeve ekzistuese, pastaj adekuatshmërinë e kapitalit, koncentrimin, vlerësimin e rrezikut të portfolios kreditorë të institucioneve individuale dhe të sistemit në tërësi, pastaj për nevoja të zbatimit të kërkesave rregullative që dalin nga Basel II sidomos lidhur me kalibrimin adekuat të kërkesave për kapital, etj.)

## Si duhet reflektuar kjo e tëra në sytë e qytetarit të rëndomtë?

Ajo çka u tha deri tash tingëllon pak a shumë teknike dhe është e kuptueshme për të gjithë në këtë sallë. Madje, në ditët në vijim ju do të shkoni edhe më thellë në elaborime teknike të tërë kësaj. Ju keni paraparë që në fund të nxjerrni edhe një Plan konkret veprimi për tërë këtë.

Mesazhi që unë dua të dërgoj tek qytetari i rëndomtë thjeshtë nga këtu është po ashtu i thjeshtë dhe domethënës: informacioni kreditor i përmirësuar duhet të ngritë transparencën dhe të zvogëlojë asimetrimin e informacionit. Kjo pastaj do të zvogëlojë një pjesë të rrezikut kreditor, ndërsa kjo do duhej të reflektojë edhe në zvogëlimin e normës së kamatave në tregun e kredisë duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit tonë. Definitivisht, emëruet i përbashkët i tërë kësaj është pikërisht ajo çka po shkruan në këtë pano para jush ku e tërë harta e vendit është e markuar me moton – të maksimizojmë rritjen ekonomike në Kosovë, për çka edhe i falënderohemi shumë USAID-së, përkatësisht Programit për përmirësimin e ambientit afarist në Kosovë.

Ju faleminderit dhe njëkohësisht ju dëshiroj sukses në punimet e këtij seminari.